

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË “IDENTITEK” SH.A.

MB.
Nr. Prot. 913/10
Dt. 15.03.2023

Në Tiranë, sot më datë 15.03.2023, themelues:

1. Ministria e Brendshme, përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm, z. Bledar Çuçi, i datëlindjes 14 nëntor 1970, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal H01114059F.

me cilësinë e “Aksionarit të vetëm” deklaroj se me vullnet të lirë e të plotë, mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimit nr. 80, datë 14.02.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”, kemi krijuar shoqërinë tregtare, sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Emri, Forma

1. Shoqëria do të ketë emrin “Identitek”, dhe formë ligjore: “Shoqëri aksionare” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

1. Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3

Selia

1. Shoqëria e ka selinë në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1001, Tiranë, Shqipëri.
2. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e shërbimit kundrejt pagesës, të prodhimit dhe shpërndarjes së:
 - a) letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike (të zakonshme, të shërbimit dhe diplomatike);
 - b) dokumentit biometrik (leje qëndrimi për të huajt për çdo motiv me përjashtim të lejes provizore dhe humanitare);
 - c) letërnjoftimit elektronik për personat që kanë përfitur statusin e refugjatit dhe mbrojtje plotësuese;
 - ç) dokumentit të udhëtimit për personat që kanë përfitur statusin e refugjatit dhe mbrojtje plotësuese;
 - d) çdo dokumenti tjetër biometrik që lëshon Ministria e Brendshme dhe institucionet në varësi të saj brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore si dhe çdo shërbim tjetër në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj.
2. Shoqëria aksionare ofron shërbime të tjera shtesë të lejuara nga legjislacioni në fuqi për subjekte publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit dhefushën e veprimtarisë së saj.
3. Shoqëria mund të kryejë aktivitete/veprimtari për studimin, projektimin, këshillimin e konsultimin për aktivitetet e përcaktuara në shkronjat a – d, të pikës 1.
4. Shoqëria brenda kufijve që parashikon legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të reja, si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.
5. Për përmbushjen e veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 5
Kohëzgjatja

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6
Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 20 000 000 (njëzet milionë) lekë, që përbëhet nga 20 000 (njëzet mijë) aksione të zakonshme, me vlerë nominale 1 000 (një mijë) lekë secili.
2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100 (njëqind) % të aksioneve të shoqërisë aksionare është Ministria e Brendshme.
3. Aksionari i Vetëm i Shoqërisë është Ministria e Brendshme, përfaqësuar nga Ministri Brendshëm.
4. Kapitali themeltar transferohet nga Ministria e Brendshme tek Shoqëria, menjëherë pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 7
Aksionet

1. Aksionet janë të formës nominale dhe lirisht të transferueshme, sipas dispozitave të ligjit nr. 62/2020, “Për tregjet e kapitalit”.
2. Aksionet dhe të drejtat e fituara si rezultat i transferimit të aksioneve nuk mund të ushtrohen kundrejt shoqërisë apo palëve të treta, përpara se ky transferim të regjistrohet në regjistrin e aksioneve.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 9
Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët emerohen prej një periudhe prej 3 vjetësh, me të drejtë riemërimi.
2. Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të “Identitek” sha zgjidhen:
 - i. Z. Andi Mahila;
 - ii. Znj. Lorena Pullumbi;
 - iii. Znj. Marbona Cuka;
 - iv. Z. Maklen Misha;
 - v. Z. Etugert Llazi.

Neni 10
Administrimi

1. Administrator i shoqërisë është:
 - Znj. Loina Prifti, i datëlindjes 26.6.1988, lindur në Durrës, identifikuar me dokument

identifikimi: Pasaportë, me numër CH1HT71RM, e pajisur me leje qëndrimi të përhershme në Republikën e Shqipërisë, Tip "C", me nr. I88626002M, emërohet në këtë detyrë për një afat 3 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Neni 11
Eksperti kontabël

1. Eksperti kontabël i Shoqërisë ka një mandat një vjeçar.
2. Ekspert kontabël i Shoqërisë emërohet znj. Alda Prençe, me adresë: Rruga "Ali Demi", Nd. 218, 1001, Tiranë, Shqipëri.

Neni 12
Baza Ligjore

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohet Statuti i Shoqërisë, si dhe dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe legjislacionit specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13
Dispozita përfundimtare

1. Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.
2. Akti i themelimit i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Aksionari i vetëm i shoqërisë tregtare "Identitek" sh.a, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.
3. Ngarkohet Administratori që të ndërmarrë të gjitha hapat dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e këtij akti themelimi dhe të statutit të shoqërisë sipas parashikimeve të ligjeve përkatëse në fuqi.

AKSIONARI I VETËM

MINISTRIA E BRENDSHME

MINISTRI

BLEDAR ÇUÇI

